

Prof. Visar Morina

Amendamenti i Gjelbër

*Konstitucionalizimi i së
drejtës për një mjedis të
pastër e të shëndetshëm në
Kosovë*

Imprint

Botuesi

Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra në Prishtinë
Rr. Pashko Vasa Nr. 23
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Përgjegjësia për përmbajtjen dhe redaktimin

Visar Morina, Autor

Kontakti

Katharina Hofmann, Drejtoreshë e FES, Zyra në Shqipëri dhe Kosovë,
katharina.hofmann@fes.de

Rudina Nallbani, Menaxhere e Programeve
rudina.nallbani@fes.de

Dizajni/Faqosja

Trembelat

Shtypja dhe prodhimi

Studio Forma

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk janë domosdoshmërisht ato të Friedrich-Ebert-Stiftung e.V. (FES). Përdorimi komercial i mediave të publikuara nga FES nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES.

Publikimet e FES nuk mund të përdoren për qëllime fushate zgjedhore.

Qershor 2026

© Friedrich-Ebert-Stiftung e.V.

Publikime të mëtejshme të Friedrich-Ebert-Stiftung mund të gjenden këtu:

➤ www.kosovo.fes.de/publications.html

Prof. Visar Morina

Amendamenti i Gjelbër

*Konstitucionalizimi i së
drejtës për një mjedis të
pastër e të shëndetshëm në
Kosovë*

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Hyrje	3
Gjelbërimi i Kushtetutës së Kosovës: Forcimi i konstitucionalizimit mjedisor ...	4
Momenti global: Rezoluta 76/300 e OKB-së dhe trendi i “Konstitucionalizimit Mjedisor” në BE.....	8
Zbrazëtira kushtetuese: Pse Kushtetuta aktuale është e pamjaftueshme për të mbrojtur qytetarët nga dëmet mjedisore?.....	10
Shembuj të padive të dështuara mjedisore në Kosovë për shkak të mungesës së statusit kushtetues	12
Grupet e cenueshme dhe mjedisi: Rreziqe shëndetësore joproporcionale ...	13
Kostoja ekonomike e mosveprimit.	15
Anëtarësimi në BE: Si përputhet amendamenti i propozuar me Kapitullin 27 të negociatave për anëtarësim në BE?.....	17
Përfundim dhe rekomandime	19

Hyrje

Kushtetuta e Kosovës (KK) është një ndër kushtetutat më të fundit në Evropë.¹ Duke qenë se është një nga kushtetutat më të reja, ajo nuk ofron mbrojtje optimale për individët përkitazi me të drejtën e tyre për të pasur një mjedis të pastër e të shëndetshëm. KK mbrojtjen e mjedisit e konsideron në rend të parë si një objektiv shtetëror dhe jo si një të drejtë themelore të zbatueshme. Ky dallim është i rëndësishëm pasi objektivat kushtetuese kryesisht i udhëzojnë autoritetet publike, ndërsa të drejtat kushtetuese u japin qytetarëve një bazë ligjore për të kërkuar mbrojtje para gjykatave të zakonshme dhe Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë dokument të politikave, do të argumentohet se është e domosdoshme që Kosova të miratojë një amendament kushtetues (Amendamenti i Gjelbër) që garanton shprehimisht të drejtën për një mjedis të pastër e të shëndetshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Ky amendament kushtetues, jo vetëm që do të forconte mbrojtjen mjedisore në dobi të individëve, por do të adresonte edhe modelet më të gjera të pabarazisë sociale dhe të qasjes së pamjaftueshme në drejtësi.

Do të argumentohet se ekzistojnë tri zbrazëtira që e bëjnë të domosdoshme këtë reformë kushtetuese. Së pari, është një zbrazëtitirë juridiksionale. Pa një të drejtë të qartë kushtetuese dhe pa një të drejtë për ta zbatuar atë, individët dhe komunitetet në Kosovë do të vazhdojnë të përballen me pengesa serioze në kërkimin e mbrojtjes gjyqësore kundër dëmit mjedisor para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (GJKK). Zbrazëtira e dytë lidhet me ndikimin e degradimit mjedisor te gratë dhe fëmijët, të cilët janë më të cenueshëm se kategoritë tjera të popullsisë. Kur burimet natyrore ndoten, gratë dhe fëmijët mund të mbajnë një barrë disproporcionale të dëmit mjedisor, si pasojë e mundësive ekonomike të tyre të kufizuara dhe pjesëmarrjes së pamjaftueshme në jetën publike. Në fund, ekziston edhe zbrazëtira socio-ekonomike që i prekë komunitetet e cenueshme. Për shembull, komunitetet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve janë shpesh më të ekspozuara ndaj rreziqeve mjedisore. Gjithashtu, ato kanë më pak mundësi për të kundërshtuar vendimet e dëmshme me anë të procedurave administrative dhe gjyqësore, si për shembull kur bëhet fjalë për operimin e deponive ilegale ose të zonave industriale.

Prandaj, adresimi i kësaj çështje nënkupton konstitucionalizimin (rregullimin me Kushtetutë) të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm e që do ta pozicionojë KK në një nivel të ngjashëm me ato kushtetuta kombëtare që e kanë të drejtën kushtetuese për një mjedis të pastër e të shëndetshëm. Për më tepër, reforma kushtetuese e propozuar nuk do të ishte vetëm një ndryshim simbolik, por do të ishte e dobishme për kategoritë më të cenueshme të shoqërisë, duke ju mundësuar atyre të kërkojnë drejtësi mjedisore para GJKK-së, kur shkelet e drejta e tyre për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Gjelbërimi i Kushtetutës së Kosovës: Forcimi i konstitucionalizimit mjedisor

Mbrojtja e mjedisit është shndërruar në një çështje kushtetuese nëpër shumë kushtetuta. Ky trend kushtetues pasqyron një pranim në rritje se një mjedis i shëndetshëm është një parakusht për gëzimin e të drejtave të tjera themelore të njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm.² Koncepti i “gjelbërimit të kushtetutës” i referohet përfshirjes së parimeve dhe të drejtave mjedisore brenda një kushtetute për të siguruar garanci më të forta ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe llogaridhënien si të autoriteteve publike, ashtu edhe të aktorëve privatë. Për shembull, Kushtetuta franceze u ndryshua në vitin 2005 dhe tani përfshin një Kartë të Mjedisit (“Karta”).³ Karta u jep të gjithë qytetarëve të Francës të drejtën për të jetuar në një “mjedis të ekuilibruar, të favorshëm për shëndetin e njeriut”.⁴

Disa nga zhvillimet më të hershme në konstitucionalizimin e mbrojtjes së mjedisit datojnë që nga vitet 1970, në të dy anët e Atlantikut, duke përfshirë Evropën dhe shtetet e SHBA-së. Konkretisht, njohja e parë kushtetuese e të drejtave mjedisore në SHBA ishte në Pensilvani, që ishte shteti i parë që e njohu këtë të drejtë që në vitin 1970.⁵ Kushtetuta e Pensilvanisë përcaktonte në Nenin 27:

*Burimet natyrore dhe prona publike - Populli ka të drejtë për ajër të pastër, ujë të pastër dhe për ruajtjen e vlerave natyrore, piktoreske, historike dhe estetike të mjedisit. Burimet natyrore publike të Pensilvanisë janë pronë e përbashkët e të gjithë njerëzve, duke përfshirë edhe brezat e ardhshëm. Si administrator i këtyre burimeve, Commonwealth-i do t'i ruajë dhe mirëmbajë ato në dobi të të gjithë njerëzve.*⁶

Një shembull tjetër ishte Kushtetuta e Hawaii-t (neni XI, paragrafi 9), e cila thotë:

“Në praktikë, konstitucionalizimi i bën dy gjëra të cilat legjislacioni i zakonshëm shpesh nuk mund t'i bëjë në mënyrë efektive: e ngritë mbrojtjen mjedisore në nivelin më të lartë normativ dhe e bën mbrojtjen mjedisore më të zbatueshme...”

“Çdo person ka të drejtë për një mjedis të pastër e të shëndetshëm, siç përcaktohet me ligj në lidhje me cilësinë mjedisore, duke përfshirë kontrollin e ndotjes dhe të burimeve. Çdo person mund ta zbatojë këtë të drejtë kundër çdo pale, publike ose private, nëpërmjet procedurave të duhura ligjore”.⁷

Në praktikë, konstitucionalizimi i bën dy gjëra të cilat legjislati i zakons-hëm shpesh nuk mund t'i bëjë në mënyrë efektive: e ngritë mbrojtjen mjedisore në nivelin më të lartë normativ (duke udhëhequr të gjitha veprimet shtetërore dhe shqyrtimin gjyqësor), dhe e bën mbrojtjen mjedisore më të zbatueshme duke e fiksuar atë në të drejta të gjykueshme dhe detyra kushtetuese.

Përgjatë dekadave të fundit, e drejta kushtetuese për një mjedis të shëndetshëm është bërë një karakteristikë e qendëruar e hartimit kushtetues. Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin vëren se e drejta për një mjedis të shëndetshëm ka “njohje dhe mbrojtje kushtetuese në më shumë se 100 shtete,” duke i përshkruar kushtetutat si “forma më e fortë e mbrojtjes ligjore në dispozicion”.⁸

Kushtetuta e Kosovës, nga ana tjetër, nuk hesht plotësisht përkitazi me mbrojtjen e mjedisit. Neni 7 e një shprehimisht mbrojtjen e mjedisit si një vlerë kushtetuese, ndërsa Neni 52 parashikon që “natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi për secilin” dhe i detyron institucionet publike t'u garantojnë të gjithëve mundësinë për të ndikuar në vendimet që prekin mjedisin në të cilin jetojnë. Në kohën e miratimit të Kushtetutës në prill 2008, këto dispozita përbënin një hap të rëndësishëm dhe vizionar, duke reflektuar një vetëdijesim se mbrojtja e mjedisit është pjesë e rendit kushtetues.

Mirëpo, ndërsa ky zhvillim pasqyronte një përkushtim të rëndësishëm ndaj qeverisjes mjedisore dhe pjesëmarrjes publike, Kushtetuta nuk e një shprehimisht të drejtën individuale për një mjedis të shëndetshëm, si një e drejtë kushtetuese e gjykueshme. Për pasojë, ky nivel i mbrojtjes kushtetuese e vë theksin në garancitë procedurale, dhe jo në një të drejtë të qartë materiale të cilën qytetarët mund ta kërkojnë drejtpërdrejt para gjykatave. Mungesa e një të drejte kushtetuese të qartë për një mjedis të shëndetshëm mund të kufizojë aftësinë e individëve dhe komuniteteve për t'i mbajtur përgjegjës, si shtetin ashtu edhe aktorët privatë për dëmin mjedisor.

Argumenti për njohjen kushtetuese të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm forcohet nga praktika kushtetuese krahasuese. Anton dhe Shelton riprodhojnë arsyetimin e Gjykatës Supreme të Montanës, e cila vendosi se garancia kushtetuese e një “mjedisi të pastër e të shëndetshëm” është e pritshme dhe parandaluese, dhe nuk kërkon prova se degradimi mjedisor ka prodhuar tashmë dëm të dukshëm ose të përcaktuar përfundimisht për shëndetin. Kjo logjikë parandaluese është veçanërisht e rëndësishme për Kosovën, ku përforsimi kushtetues i së drejtës do të forconte ndërhyrjen e hershme gjyqësore dhe do të zvogëlonte rrezikun që mbrojtja e mjedisit të mbetet reaktive dhe jo e bazuar në të drejta.⁹

Në shumë kushtetuta, është e paraparë e drejta për një mjedis të shëndetshëm, e cila autorizon organet administrative dhe gjykatat të rishikojnë politikat qeveritare dhe aktivitetet private që mund të shkaktojnë degradim mjedisor që ndikon në shëndetin dhe mirëqenien e njeriut. Gjithashtu, zhvillimet e fundit në të Drejtën ndërkombëtare janë në mbështetje të këtij trendi. Në veçanti, Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 28 korrik 2022 (A/RES/76/300), njohu zyrtarisht të drejtën e njeriut për një mjedis të pastër, të shëndetshëm e të qëndrueshëm. Rezoluta u bën thirrje shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe bizneseve që të shtojnë përpjekjet për të siguruar një mjedis të shëndetshëm për të gjithë. Edhe pse rezoluta nuk është ligjërish e detyrueshme, ajo pasqyron një konsensus global në zhvillim për rëndësinë e garantimit të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm dhe kontribuon në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që e lidhin mbrojtjen e mjedisit me të drejtat themelore të njeriut.

Arsyet e identifikuar nga Anton dhe Shelton për përfshirjen e garancive kushtetuese për një mjedis të pastër e të shëndetshëm në shtetet si Hawaii, Illinois, Montana dhe Texas mbeten shumë të rëndësishme për kontekstin e Kosovës.¹⁰ Siç vërejnë ata, “përfshirja e dispozitave në kushtetutë duhet të shërbejë për një qëllim tjetër dhe jo vetëm thjesht për dhënie të pushtetit legjislativ mbi çështjet mjedisore”.¹¹ Në Kosovë, justifikimi më i fortë për futjen e një amendamenti të gjelbër është pikërisht ngritja e mbrojtjes së mjedisit nga niveli i politikës së zakonshme legjislative dhe rregullatore, në atë të një të drejte kushtetuese. Një amendament i tillë do të konfirmonte se mbrojtja e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm nuk është vetëm çështje e diskrecionit politik ose gjyqësor, por është një e drejtë që garantohet nga akti më i lartë ligjor.

Arsyeja e dytë është zgjerimi i statusit të individëve para GJKK-së për të lejuar padi civile kushtetuese kur shkelet e drejta kushtetuese për një mjedis të pastër e të shëndetshëm. Siç u tha më lart, Kushtetuta e Kosovës nuk e njeh të drejtën për një mjedis të shëndetshëm si një e drejtë kushtetuese individuale. Për rrjedhojë, Gjykatës Kushtetuese i mungon një *ratione materiae* e qartë për të gjykuar kërkesat mjedisore si ankesa kushtetuese autonome. Me fjalë tjera, edhe kur degradimi mjedisor është i rëndë dhe ka pasoja të rënda për shëndetin, dinjitetin, barazinë, pronën ose cilësinë e jetës, parashtraset e kësaj natyre arrijnë në Gjykatë vetëm në mënyrë indirekte, përmes prizmës së doktrinëve të të drejtave tjera kushtetuese (bie fjala, të drejta për jetë familjare). Ajo që është edhe më shqetësuese është se GJKK-ja, që nga themelimi i saj, nuk ka treguar një shkallë aktivizmi gjyqësor për të njohur të drejtën për një mjedis të shëndetshëm brenda fushëveprimit të Nenit 7 të Kushtetutës së Kosovës.

Në praktikë kjo do të thotë që mjedisi nuk trajtohet si një e drejtë kushtetuese e mbrojtur, por vetëm për aq sa mund t'i bashkëngjitet një të drejtë tjetër të njohur. Një rregullim i tillë kushtetues e dobëson pozicionin e individëve para GJKK-së, e që përfundimisht do të thotë se ata do të kenë më pak mbrojtje kushtetuese kur ndodh dëmi mjedisor.

Arsyeja e tretë për futjen e amendamentit të gjelbër është të sigurohet që mjedisi natyror të marrë të njëjtin nivel të njohjes dhe mbrojtjes kushtetuese sikurse vlerat tjera themelore që tashmë mbrohen nga Kushtetuta, duke përfshirë të drejtat politike dhe civile. Një rend kushtetues që e mbron lirinë e shprehjes, barazinë, dinjitetin, pronën dhe procesin e rregullt ligjor, por nuk mbron shprehimisht kushtet mjedisore të nevojshme për jetën dhe shëndetin e njeriut, mbetet jo i plotë. Ajri i pastër, uji i sigurt, toka e pandotur dhe një klimë e qëndrueshme nuk janë thjesht objektiva politike. Këto paraqesin parakushtet themelore për gëzimin efektiv të të gjitha të drejtave tjera. Pa një mjedis të shëndetshëm, garancitë kushtetuese për të drejtat e tjera mund të mbeten vetëm formale pa ndikim të rëndësishëm. Duke e ngritur mbrojtjen e mjedisit në status kushtetues, shteti pranon se integriteti ekologjik nuk është dytësor ndaj të drejtave të njeriut, por konsiderohet të jetë i pandashëm prej tyre. Në këtë kuptim, amendamenti i gjelbër do të korrigjonte një çekuilibër ekzistues në strukturën kushtetuese duke pohuar se mbrojtja e natyrës, shëndetit publik dhe brezave të ardhshëm meriton të njëjtën forcë normative dhe vëmendje gjyqësore sikurse për mbrojtjen e të drejtave politike.

Në këtë situatë, gjelbërimi i Kushtetutës së Kosovës do të përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të vendit me standardet ndërkombëtare në zhvillim dhe praktikën krahasuese kushtetuese. Përfshirja e një të drejte të qartë kushtetuese për një mjedis të shëndetshëm do të forconte qeverisjen mjedisore, do të përmirësonte qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore dhe do t'i avanconte mekanizmat e llogaridhënies për dëmet mjedisore.

Momenti global: Rezoluta 76/300 e OKB-së dhe trendi i “Konstitucionalizimit Mjedisor” në BE

Miratimi i Rezolutës 76/300 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në korrik 2022, përfundimisht shënon një ndryshim në të drejtën ndërkombëtare, duke e ngritur të drejtën për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm nga një parim rajonal i fragmentuar në një të drejtë njerëzore të njohur universalisht. Edhe pse ky instrument nuk është ligjërisht i detyrueshëm në të njëjtën mënyrë siç është një traktat, Rezoluta 76/300 shërben si një katalizator i fuqishëm normativ duke pranuar se degradimi mjedisor, ndryshimi i klimës dhe humbja e biodiversitetit janë kërcënime ndaj gëzimit të të gjitha drejtave të njeriut.

Kjo Rezolutë siguroi njohje politike universale se e drejta për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm është një e drejtë njerëzore. Përpara Rezolutës 76/300, kjo e drejtë njihej në mënyrë të pabarabartë në të gjitha kushtetutat kombëtare, sistemet rajonale dhe disa organe të OKB-së, por jo me të njëjtin nivel të miratimit universal nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Për më tepër, ajo siguroi legjitimitet shtesë për gjykatat, organet kushtetuese dhe institucionet kuazi-gjyqësore që të mbështeten në argumentet e të drejtave mjedisore të njeriut. Në praktikë, ajo u jep gjyqtarëve dhe palëve në gjyq një bazë më të fortë për të thënë se mbrojtja e mjedisit nuk është vetëm një preferencë politike, por edhe një çështje e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.



Në BE, mbrojtja e mjedisit historikisht është trajtuar si një objektiv i politikave ose një e drejtë dytësore. Megjithatë, trendi aktual po shkon drejt konstitucionalizimit të drejtpërdrejtë. Neni 37 i Kartës së BE-së përcakton se një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit duhet të integrohet në politikat e BE-së. Ndërsa fillimisht shihej si një “parim” dhe jo si një “e drejtë”, diskursi dhe veprimet në rastet civile kohëve të fundit sugjerojnë për një ndryshim drejt bërjes së të drejtës për një mjedis të shëndetshëm, si një e drejtë subjektive dhe e zbatueshme. Nga ana tjetër, shumë shtete anëtare të BE-së i kanë ndryshuar kushtetutat e tyre për të përfshirë «amendamentet e gjelbra». Në përgjithësi, mund të identifikohen tri qasje në lidhje me fushëveprimin e reformave kushtetuese për të adresuar këtë çështje:

- **Të Drejtat materiale:** Dhënia individëve e një të “drejte për një mjedis të shëndetshëm” (p.sh., Spanja, Franca, Belgjika)¹².
- **Objektivat e Shtetit:** Përcaktimi i mbrojtjes së mjedisit si një obligim i detyrueshëm i shtetit (p.sh., Neni 20a i Gjermanisë).
- **Barazia Ndërbrezore:** Konstitucionalizimi i të drejtave për brezat e ardhshëm për një klimë të qëndrueshme (Neni 112 i Kushtetutës së Norvegjisë).¹³

Gjatë dekadave të fundit, konstitucionalizmi evropian e ka njohur gjithnjë e më shumë mbrojtjen e mjedisit si një vlerë themelore, duke e integruar atë me të drejtat materiale, si dhe me detyrimet shtetërore në kushtetutat e tyre kombëtare. Vendet si Spanja (Neni 45, Kushtetuta e vitit 1978), Franca (Karta për Mjedisin, 2004, Neni 1) dhe Belgjika (Neni 23, Kushtetuta) u japin në mënyrë të qartë individëve të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, duke reflektuar një trend drejt të drejtave individuale mjedisore. Ndërkohë, shtetet si Gjermania (Neni 20a, E drejta themelore), Portugalia (Neni 66, Kushtetuta) dhe Norvegjia (Neni 112, Kushtetuta) theksojnë detyrën e shtetit për të mbrojtur burimet natyrore, shpesh të interpretuara që të sigurojnë mjedisin për brezat e ardhshëm, duke ilustruar dimensionin ndërbrezor të mbrojtjes së mjedisit.

Kushtetutat e Evropës Lindore dhe Juglindore, si Sllovenia (Neni 72), Kroacia (Neni 70) dhe Polonia (Neni 74), i reflektojnë të njëjtat parime, duke përfshirë shpesh pjesëmarrjen e qytetarëve dhe qasjen në informacionin mjedisor si pjesë e të drejtave të zbatueshme.

Këto zhvillime kushtetuese janë ndikuar fuqishëm nga normat ndërkombëtare dhe institucionet e BE-së. Në nivel global, Korniza e Kombeve të Bashkuara, veçanërisht Deklarata e OKB-së mbi të Drejtën për Zhvillim (1986), Deklarata e Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (1992), dhe UNFCCC dhe Marrëveshja e Parisit (2015), e kanë specifikuar detyrimin e shteteve për të mbrojtur mjedisin dhe për të adresuar ndryshimet klimatike për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Shtetet evropiane i kanë përfshirë këto parime në tekstet kushtetuese, duke reflektuar ndërveprimin midis angazhimeve ndërkombëtare dhe ligjit kombëtar.

Zbrazëtira kushtetuese: Pse Kushtetuta aktuale është e pamjaftueshme për të mbrojtur qytetarët nga dëmet mjedisore?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e njeh mbrojtjen e mjedisit, por ende nuk e njeh atë si një të drejtë themelore të plotë dhe të zbatueshme drejtpërdrejt. Neni 7 paragrafi 1, përfshin mbrojtjen e mjedisit midis vlerave kushtetuese të shtetit, ndërsa Neni 52 e përcakton mjedisin kryesisht në kuptim të përgjegjësisë kolektive, pjesëmarrjes publike dhe konsideratës institucionale në vendim-marrje. Asnjëra dispozitë nuk u garanton shprehimisht individëve një të drejtë thelbësore për të jetuar në një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm. Siç është e hartuar aktualisht, Kushtetuta pasqyron një qasje programike dhe të orientuar drejt qeverisjes, në vend të një garancie kushtetuese të bazuar në të drejta e të aftë për zbatim të drejtpërdrejtë gjyqësor. Ky ishte edhe mendimi i shprehur nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile (OSHC-të) gjatë një fokus-grupi të organizuar nga FES-i. Të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord që Kushtetuta e Kosovës duhet të ndryshohet për të ofruar një garanci më të fortë kushtetuese të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm e të pastër.¹⁴ Për më tepër, kur diskutuan për rëndësinë e përfshirjes së kësaj të drejte kushtetuese, përfaqësuesit e OSHC-ve theksuan se nuk është e përshatshme që individët dhe organizatat e shoqërisë civile të kryejnë punën e institucioneve publike. Mbrojtja e mjedisit në rend të parë duhet të jetë një detyrë ligjore e institucioneve publike, ndërsa individët gjithashtu duhet të kontribuojnë deri në masën e mundshme. Kjo zbrazëtirë bëhet më serioze kur të shihet në raport me situatën aktuale mjedisore në Kosovë. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2025, konkludon se Kosova mbetet në një fazë të hershme të përgatitjes në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike dhe ka bërë vetëm përparim të kufizuar gjatë periudhës së raportimit. Raporti vëren më tej se kapacitetet administrative, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal mbeten të kufizuara, se financimi i pamjaftueshëm vazhdon të pengojë zbatimin dhe se këto dobësi pengojnë seriozisht përparimin në këtë sektor. Veçanërisht shqetësues është konstatimi i Komisionit se nuk ka përparim në cilësinë e ajrit, e cila vazhdon të paraqesë një rrezik të madh për shëndetin, ndërsa emetimet e SO₂, NO_x dhe pluhurit u rritën dhe tejkaluan kufijtë e lejuar të emetimeve. I njëjti raport përmend gjithashtu një përparim të kufizuar në menaxhimin e mbeturinave, vonesat në legjislacionin kyç dhe një rritje të numrit të deponive ilegale, nga 403 në vitin 2024 në 458 në vitin 2025.¹⁵

Raporti vjetor i Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AMMK), e përforcon këtë qëndrim nga perspektiva e brendshme. Raporti e lidh në mënyrë të qartë ndotjen mjedisore me përkeqësimin e shëndetit publik dhe vdekshmërinë e parakohshme, duke theksuar në veçanti efektet e dëmshme të grimcave PM10 dhe PM2.5 për shkak të mundësisë së tyre për të depërtuar thellë në mushkëri dhe për të shkaktuar pasoja të rënda shëndetësore. Raporti gjithashtu identifikon dobësitë strukturore në qeverisjen mjedisore, duke përfshirë mosfunksionimin e Bordit Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit dhe për mosfunksionalizimin e Eko-Fondit, pavarësisht faktit se të ardhurat e mbledhura në emër të mbrojtjes së mjedisit shkojnë në buxhetin e Kosovës dhe jo për projekte mjedisore.¹⁶

Kur shihen së bashku, këto gjetje tregojnë se modeli aktual kushtetues është i papërshtatshëm për shkallën dhe urgjencën e dëmit mjedisor në Kosovë. Aty ku degradimi mjedisor kërcënon shëndetin publik, biodiversitetin, burimet ujore dhe cilësinë e jetës së brezave të tanishëm dhe të ardhshëm, mbrojtja kushtetuese nuk mund të mbetet e kufizuar vetëm në vlera të gjera dhe garanci procedurale (siç është pjesëmarrja publike në çështjet mjedisore). Një kushtetutë që bazohet vetëm në pjesëmarrje dhe detyra të përgjithshme institucionale i lë qytetarët të varur nga legjislacioni i zakonshëm dhe zbatimi administrativ, të cilat të dyja mbeten të cënueshme ndaj dobësive institucionale, vonesave dhe zbatimit joadekuat.

Është e vërtetë që legjislacioni mjedisor i Kosovës tashmë përfshin parime të rëndësishme si parandalimi, masat paraprake, ndotësi paguan, qasja publike në informacion dhe qasja në drejtësi. Këto janë deklaruar më qartë në nenin 6 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe janë operacionalizuar më tej në legjislacionin sektorial siç janë neni 3, neni 6 dhe neni 84 i Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe neni 5 i Ligjit nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.¹⁷

Megjithatë, legjislacioni i zakonshëm nuk mund ta zëvendësojë plotësisht njohjen kushtetuese të vetë të së drejtës. Në mungesë të një të drejte kushtetuese të qartë për një mjedis të shëndetshëm, individët përballen me pengesa serioze kur kërkojnë mbrojtje kushtetuese kundër veprimeve ose mosveprimeve të dëmshme për mjedisin. Mjetet juridike administrative dhe gjyqësore janë shpesh të gjata dhe teknikisht komplekse. Siç theksuan pjesëmarrësit në takimin e Fokus-grupit, gjyqtarët që merren me lëndët mjedisore shpesh nuk janë mjaftueshëm të specializuar për të gjykuar çështje të tilla në mënyrë efektive. Kjo është veçanërisht problematike duke pasur parasysh se mosmarrëveshjet mjedisore shpesh janë komplekse, duke përfshirë çështje shkencore, teknike dhe rregullatore që kërkojnë një nivel të caktuar të njohurive dhe ekspertizës paraprake për zgjidhjen e tyre të duhur. Në këtë kontekst, gjithashtu u vërejt se Kosova humbi një mundësi të rëndësishme, gjatë themelimit të Gjykatës së re Administrative, për të krijuar një departament të specializuar që do të merrej posaçërisht me çështjet mjedisore. Për më tepër, një palë duhet të shterojë mjetet juridike administrative dhe të kalojë nëpër procedura gjyqësore përpara se të mund ta iniciojë çështjen në GJKK. Në praktikë, ky proces mund të zgjasë me vite, ndoshta edhe afër një dekade. Megjithatë, edhe atëherë, rruga drejt shqyrtimit kushtetues mbetet e pasigurt. Kur këto mjete juridike dështojnë, pranimi i rastit në GJKK nuk është i garantuar, pasi kërkesat mjedisore mund të konsidero-

hen ende si jashtë fushëveprimit të të drejtave kushtetuese të mbrojtura në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ky fakt sigurisht që e dobëson funksionin parandalues dhe korrigjues të gjykimit kushtetues dhe i lë interesat mjedisore të pambrojtura në mënyrë strukturore.

Shembuj të padive të dështuara mjedisore në Kosovë për shkak të mungesës së statusit kushtetues

Kushtetuta e Kosovës, jo vetëm që i ka kufizimet e veta në lidhje me të drejtën për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, por as Gjykata Kushtetuese nuk ka treguar shenja aktivizmi gjyqësor për të ndjekur një interpretim më të zgjeruar të Nenit 7 të Kushtetutës dhe për ta njohur këtë të drejtë në kontekstin material. Rëndësia e këtij vendimi është se ai i tregon kufijtë e statusit kushtetues në çështjet mjedisore sipas Kushtetutës së Kosovës.

Kjo ilustron më së miri në *rastin KI 56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*, në të cilin aplikantët kundërshtuan një vendim komunal të datës 30 prill 2009, që ndryshonte planin e detajuar urban për lagjen Jaglenica/Dardania në Prizren. Ky ndryshim do ta shndërronte një zonë të gjelbër ekzistuese në një vendbanim me ndërtesa të larta për familjet e dëshmorëve dhe rastet sociale. Aplikantët argumentuan, mes tjerash, se vendimi ishte miratuar pa asnjë debat publik ose pjesëmarrje publike. Banorët paraqitën një peticion të nënshkruar nga 393 banorë, më vonë iu drejtuan Avokatit të Popullit dhe gjithashtu kontaktuan Ministrinë e Mjedisit, por nuk morën një përgjigje efektive.

Gjykata u bazua në Nenin 113(7), i cili u lejon individëve t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm për shkeljet e pretenduara nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara nga Kushtetuta, pas shterimit të të gjitha mjeteve ligjore.

Kjo ka rëndësi sepse Kushtetuta e Kosovës nuk e përcakton qartë një të drejtë të gjerë, autonome dhe materiale individuale “për një mjedis të shëndetshëm”, të cilën çdo person mund ta inicojë thjesht për faktin se vlerat mjedisore janë në rrezik. Në vend të kësaj, Gjykata e forcoi pranueshmërinë sipas Nenit 52(2) të Kushtetutës, i cili u garanton të gjithëve mundësinë për të ndikuar në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin në të cilin jetojnë. Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme sepse aplikantët u prekën drejtpërdrejt nga vendimi i planifikimit në mjedisin e tyre të jetesës dhe, më e rëndësishmja është se korniza e zakonshme administrative-gjyqësore nuk u ofroi atyre një mjet juridik efektiv: akti komunal i kontestuar nuk ishte një akt “individual”, dhe ligji i zbatueshëm për Konfliktet administrative nuk u ofroi atyre një orientim gjyqësor për ta kundërshtuar atë në lidhje me të drejtën e garantuar nga Neni 52.

Prandaj, vendimi duhet të lexohet si njohje e statusit kushtetues procedural, e jo si pohim i një statusi të plotë kushtetues për të pretenduar një të drejtë thelbësore të pavarur për një mjedis të shëndetshëm. Gjykata nuk argumentoi se aplikantët kanë të drejtë për një mjedis të shëndetshëm. Përkundrazi,

Gjykata vendosi vetëm se ata kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimarrjen mjedisore sipas Nenit 52 (2) të Kushtetutës, pasi plani ishte miratuar pa diskutim publik ose pjesëmarrje tjetër.

Ky rast në të vërtetë e mbështetë konkludimin se Kushtetuta e Kosovës nuk ofron legjitimitet të gjerë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore të një të drejte kushtetuese materiale për një mjedis të shëndetshëm. Përkundrazi, ajo lejon legjitimitet kur aplikanti mund ta lidhë çështjen mjedisore me një garanci kushtetuese specifike dhe të individualizuar (garancia pjesëmarrëse në Nenin 52(2). Në këtë kuptim, KI 56/09 e konfirmon si hapjen ashtu edhe kufizimin e mbrojtjes kushtetuese mjedisore në Kosovë: ekziston mbrojtja kushtetuese për pjesëmarrjen mjedisore, por ende jo si një e drejtë kushtetuese e përgjithshme e përcaktuar shprehimisht dhe e zbatueshme drejtpërdrejt për një mjedis të shëndetshëm.

Gjetjet e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën ndihmojnë në shpjegimin e paradoksit se, përkundër një situatë mjedisore seriozisht të degraduar, Kosova tregon një aktivizëm të kufizuar për paditë mjedisore dhe ato gjyqësore. Raporti thekson kufizime më të gjera sistemike që ndikojnë në mënyrë indirekte në drejtësinë mjedisore, veçanërisht: në zbatimin e dobët të ligjeve, kapacitetin e kufizuar institucional dhe në një ngadalësim të përgjithshëm në proceset e reformave për shkak të jostabilitetit politik dhe sfidave të qeverisjes.¹⁸

Për dallim, trendet globale tregojnë një zgjerim të shpejtë të rasteve civile mjedisore dhe klimatike, me mbi 3,000 raste në të gjithë botën, ku gjykatat shërbejnë gjithnjë e më shumë si arena kyçe për qeverisjen mjedisore. Kjo divergjencë nënvizon se niveli i ulët i padive mjedisore në Kosovë nuk është thjesht një çështje e pasivitetit qytetar, por më tepër një rezultat sistematik i hartimit kushtetues, qasjes së kufizuar në drejtësi dhe zbatimit të dobët institucional.¹⁹

Grupet e cënueshme dhe mjedisi: Rreziqe shëndetësore joproporcionale

Degradimi mjedisor në Kosovë ka një ndikim disproporcional tek gratë dhe fëmijët, veçanërisht në “pikat e nxehta” industriale si, Mitrovica dhe Obiliqi. Këto zona janë të njohura për ekspozimin afatgjatë nga ndotja e ajrit prej termocentraleve me bazë tëhëngjilli dhe aktivitetet e rënda industriale, si dhe për ndotjen e tokës dhe ujit me substanca toksike. Në fakt, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar një ligj të veçantë që e shpallte Komunën e Obiliqit dhe rrethinat e saj si zonë me rrezik të veçantë mjedisor, si pasojë e ndotjes së vazhdueshme të ajrit, tokës dhe ujit, me synim përmirësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut.²⁰ Ligji gjithashtu përcakton që komuna në bashkëpunim me Ministrinë duhet të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për të zvogëluar ndikimin negativ në mjedis që rezulton drejtpërdrejt ose tërthorazi nga burimet e ndotjes mjedisore.

Studimet tregojnë se ndotja mjedisore nga kompleksi industrial i Trepçës e ka sjellë ndotjen në nivele të rrezikshmërisë së lartë të ekspozimit ndaj plumbit,

veçanërisht tek fëmijët, me pasoja të matshme shëndetësore, si dëmtime neurologjike dhe çrregullime në zhvillim.²¹ Raportet ndërkombëtare e kanë përshkruar situatën e komunitetit rom të zhvendosur në të njëjtin rajon, si një “krizë e madhe shëndetësore”, ku ekspozimi ndaj tokës dhe ajrit të kontaminuar me plumb e kërcënon drejtpërdrejt të drejtën e tyre për shëndet.²²

Ndotja e ajrit paraqet një rrezik po aq serioz dhe të përhapur. Sipas të dhënave nga UNICEF-i, rreth 99% e fëmijëve në Kosovë janë të ekspozuar ndaj niveleve të ndotjes së ajrit që tejkalojnë standardet e OBSH-së, me përqendrimet të grimcave të materieve që tejkalojnë deri në 25 herë kufijtë e lejuar dhe rrisin ndjeshëm rrezikun nga sëmundjet e frymëmarrjes dhe nga vdekshmëritë.²³ Hulumtimet mjekësore konfirmojnë më tej se rritjet e ndotjes prej grimcave në ajër janë të lidhura drejtpërdrejt me nivelin më të lartë të vizitave dhe shtrimeve në spital tek fëmijët, duke demonstruar një lidhje të qartë kauzale midis ekspozimit mjedisor dhe rezultateve shëndetësore.²⁴

Sipas perspektivës gjinore, këto nivele të degradimit mjedisor tregojnë ndikimin e konsiderueshëm që kjo ndotje ka tek gratë dhe fëmijët, kryesisht në rajonin e Mitrovicës dhe Obiliqit. Gratë dhe veçanërisht gratë shtatzëna përballen me cenueshmëri të shtuar për shkak të rrugëve të ekspozimit brenda familjes dhe roleve të kujdesit, ndërsa fëmijët janë më të ndjeshëm ndaj ndotësve. Këto nivele dhe forma të dëmit mjedisor që ndikojnë në shëndetin e këtyre kategorive të popullsisë mund të ngrejë edhe çështjen e pabarazisë gjinore. Mbrojtja e mjedisit do të vazhdojë të mbetet e dobët në Kosovë për sa kohë që grupet e prekura (gratë dhe fëmijët) nuk janë në gjendje të zbatojnë të drejtat e tyre në lidhje me mjedisin e shëndetshëm dhe barazinë.

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike pohon hapur se ndikimet nga ndryshimet klimatike nuk do t'i prekin të gjithë në mënyrë të barabartë; ata që janë tashmë të cenueshëm në shoqëri përballen me rreziqet më të mëdha. Është thelbësore që të forcohet mbrojtja sociale dhe ofrimi i mbështetjes së synuar për grupet me rrezikshmëri të lartë që janë më të cenueshëm ndaj ndikimeve shëndetësore të lidhura me klimën, siç janë personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, pacientët me sëmundje kronike, gratë shtatzëna, fëmijët e vegjël, familjet ekonomikisht të pafavorizuara dhe komunitetet gjeografikisht të izoluar.²⁵

Nga perspektiva e të drejtave të njeriut, cenueshmëria e grave dhe fëmijëve në situata të degradimit mjedisor është pranuar gjithashtu në mënyrë të qartë në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në çështjen *Jugheli dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, Gjykata shqyrtoi ekspozimin e zgjatur të banorëve ndaj ndotjes industriale dhe theksoi se grupe të caktuara, veçanërisht fëmijët dhe gratë, mund të përballen me rreziqe të larta për shkak të rrethanave të tyre specifike biologjike dhe sociale. Gjykata e pranoi statusin e viktimës për aplikantët e prekur nga dëmi mjedisor dhe njohu se ekspozimi ndaj ndotjes mund të ndikojë në mënyrë disproporcionale në grupet e cenueshme, duke përfunduar detyrimet pozitive të shtetit sipas Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të siguruar mbrojtje

efektive të shëndetit dhe mirëqenies. Gjykata shtoi se «në kontekstin e aktiviteteve veçanërisht të rrezikshme, shtetet e kanë për obligim të vendosin rregullore të orientuara drejt karakteristikave specifike të aktivitetit në fjalë, veçanërisht në lidhje me nivelin e rrezikut të përfshirë potencialisht. Ato duhet të rregullojnë licencimin, ngritjen, operimin, sigurinë dhe mbikëqyrjen e aktivitetit dhe duhet ta bëjnë të detyrueshme për të gjithë të interesuarit që të marrin masa praktike për të siguruar mbrojtjen efektive të qytetarëve, jeta e të cilëve mund të rrezikohet nga rreziqet e përhershme».²⁶ Kjo qasje përforcohet më tej nga Dhoma e Madhe në *çështjen Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerë kundër Zvicrës*, ku Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut i njohu në mënyrë të qartë gratë e moshuara si një grup veçanërisht i cënueshëm, i prekur në mënyrë disproporcionale nga ndryshimet klimatike dhe u pranoi statusin e viktimës në dritën e rreziqeve reale dhe serioze ndaj shëndetit dhe mirëqenies së tyre.²⁷

Bazuar në shembullin e Kosovës dhe qasjes së jurisprudencës së GJEDNJ-së, rezulton se degradimi mjedisor përforcon pabarazitë ekzistuese: ata me më pak burime dhe përgjegjësi më të mëdha të kujdesit (kryesisht gratë) mbajnë një barrë disproporcionale nga dëmi, ndërsa përfitojnë më së paku nga aktivitetet ekonomike që gjenerojnë ndotje. Kjo dëshmon një nevojë të qartë për qeverisje mjedisore që i përgjigjet çështjeve gjinore dhe për qasje të përmirësuar në drejtësi, veçanërisht përmes një mbrojtjeje më të fortë kushtetuese dhe një pozicioni më të gjerë në çështjet mjedisore.

Kostoja ekonomike e mosveprimit

Mund të argumentohet gjithashtu se dështimi për të garantuar të drejtën kushtetuese për një mjedis të shëndetshëm ka pasoja të rënda ekonomike për Kosovën. Ekzistojnë disa vlerësime të kryera nga organizatat ndërkombëtare që kanë ofruar të dhëna konkrete në lidhje me kostot e mosveprimit të shtetit për të trajtuar dëmet mjedisore dhe ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike në ekonominë e Kosovës.

Banka Botërore argumenton se në Kosovë vlerësohet se kostoja vjetore e degradimit mjedisor ishte midis 123 milionë dhe 323 milionë euro, me një pikë mesatare prej 221 milionë euro, ose rreth 5.3% të BPV-së; vetëm ndotja e ajrit u vlerësua të kushtonte rreth 98 milionë euro në vit në dëmtime shëndetësore sipas një vlerësimi të mëparshëm, dhe vlerësimet e mëvonshme e vendosën koston ekonomike të ndotjes së ajrit të ambientit që lidhet me shëndetin në 160-310 milionë dollarë amerikanë në vit, ekuivalente me 2.5-4.7% të PBV-së.²⁸ Këto janë kosto shumë të larta për buxhetin dhe ekonominë e Kosovës, të cilat shfaqen në formën e rritjes së shpenzimeve shëndetësore publike dhe private, humbjes së produktivitetit, vdekshmërisë së parakohshme, uljes së mësimnxënies dhe kapitalit njerëzor, dhe rënies së atraktivitetit për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Raportet më të fundit për klimën në Kosovë arrijnë në të njëjtin përfundim në një nivel strategjik. Banka Botërore ka vlerësuar se vendit do t'i duhen rreth 2.8 miliardë dollarë amerikanë gjatë dekadës së ardhshme për të mbrojtur njerëzit dhe pronën nga përshkallëzimi i ndikimeve klimatike, ndërsa konstaton shprehi-

misht se kostot e mosveprimit janë edhe më të larta.²⁹ Të dhënat e sugjeruara janë vërtet alarmante dhe duhet të merren parasysh nga autoritetet vendimmarrëse për të forcuar themelin kushtetues të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm, para se të jetë tepër vonë. Edhe pse Kosova ende nuk është përballur me raste të mëdha gjyqësore në lidhje me dëmet mjedisore me implikime serioze ekonomike për autoritetet publike ose operatorët e biznesit, kjo mungesë nuk duhet interpretuar si provë për një rrezik të kufizuar. Përkundrazi, duhet të kuptohet si një paralajmërim se veprimi në kohë, në mënyrë konkrete dhe parandaluese është i nevojshëm për të zvogëluar dëmet e ardhshme mjedisore dhe për të zbutur pasojat ligjore dhe ekonomike të cilat përndryshe mund të shfaqen.

Nga ana tjetër, pjesëmarrësit në takimin e Fokus-grupit shprehën shqetësimin se, në dritën e mungesës së energjisë në Kosovë, balancimi i këtyre interesave konkurruese mbetet veçanërisht sfidues. Ndërsa kalimi në projekte të gjelbra është i nevojshëm, projektet e tilla shpesh janë të kushtueshme dhe kërkojnë investime të konsiderueshme. Në të njëjtën kohë, ekziston një tendencë për të ruajtur burimet dhe infrastrukturën ekzistuese të energjisë, edhe pse shumë prej tyre nuk arrijnë të përmbushin standardet mjedisore.

Në bazë të këtyre konsideratave, dështimi për të mbrojtur të drejtën për një mjedis të shëndetshëm nuk është vetëm një shqetësim kushtetues dhe i të drejtave të njeriut, por gjithashtu do të thotë një barrë makroekonomike për shtetin dhe shoqërinë, duke e zhvendosur çmimin e dëmit mjedisor te sistemi shëndetësor, tregu i punës dhe te perspektivat e zhvillimit të ardhshëm.³⁰ Fig. 1.³¹

KOSTOT E MOSVEPRIMIT



Dëmet vjetore të pritshme janë vlerësuar të arrijnë 2-4% 1 GDP-së në 2050 sipas RCP4.5



Ngjarjet ekstreme të njëhershme mund të çojnë në humbje jetës, lëndime, shkatërrim të mjeteve të jetesës dhe ulje të ndjeshme rezultateve ekonomike në periudhë afatgjat

↓ ↓ ↓

Vlerësimi i ndikimeve nëpërmjet modelimit makro të kanaleve të zgjedhura të ndikimit ofron ofron një vlerësim më të ulët të ndikimeve.



KOSTOT E VEPRIMIT

-2.8 miliardë USD në 30 vitet e ardhshme

↓ ↓ ↓

Vlerësimet gjithëpërfshirëse nga poshtë-lart të bazuara në të dhëna nga modele sektoriale specifike dhe vlerësimet ekspertësh.



PËRFITIMET NGA VEPRIMI

Reduktimi i dëmeve për jetën, infrastrukturën dhe pronën (25%-50%).

Raportet e përfitimeve ndaj kostove (B/C) investimeve në përshtatje variojnë nga 2-10 për çdo 16 të investuar

↓ ↓ ↓

Raportet B/C dhe Dividenti Triple-A.

Anëtarësimi në BE: Si përputhet amendamenti i propozuar me Kapitullin 27 të negociatave për anëtarësim në BE?

Kapitulli 27 i *acquis* së BE-së, që mbulon mjedisin dhe ndryshimet klimatike, është një nga fushat më të kërkuara të procesit të anëtarësimit, që përmban mbi 200 akte ligjore dhe që kërkon jo vetëm harmonizim legjislativ, por edhe ndryshime të thella institucionale, shoqërore dhe të sjelljes.³² Përveç rregullimit sektorial (cilësia e ajrit, mbeturinat, uji, ndotja industriale), kapitulli përfshin edhe një dimension të fortë «horizontal» të fokusuar në të drejtat procedurale, si qeverisja mjedisore, pjesëmarrja publike dhe zbatimi efektiv që janë esenciale për përmirësimin e vendimmarrjes dhe zbatimit.³³ Këto kërkesa tregojnë se anëtarësimi në BE në fushën mjedisore shkon përtej transpozimit formal dhe varet nga ekzistenca e një kuadri të fuqishëm ligjor të aftë për të siguruar mbrojtje efektive të interesave dhe të drejtave mjedisore. Në këtë kontekst, njohja kushtetuese e së drejtës për një mjedis të shëndetshëm në Kosovë do ta forconte ndjeshëm rendin ligjor të brendshëm duke ofruar një garanci themelore dhe të gjykueshme që mbështet zbatimin, shqyrtimin gjyqësor dhe llogaridhënien institucionale.

Amendamenti kushtetues i propozuar që paraqet një të drejtë të qartë për një mjedis të shëndetshëm jo vetëm që do të rriste nivelin e mbrojtjes së të drejtave mjedisore në Kosovë, por do të përputhej edhe me kërkesat strukturore të përmendura në Kapitullin 27 të *acquis* së BE-së. Edhe pse BE-ja nuk u kërkon zyrtarisht vendeve candidate të ndryshojnë kushtetutat për të përfshirë të drejtën për një mjedis të pastër, procesi i pranimit kërkon që vendet candidate të sigurojnë një nivel të lartë të mbrojtjes mjedisore, zbatim efektiv dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore. Këto obligime rrjedhin nga vetë *acquis*-ja mjedisore, si dhe nga parimet horizontale të mishëruara në ligjin parësor të BE-së, duke përfshirë Nenin 37 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe Nenin 191 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, të cilat përcaktojnë mbrojtjen e mjedisit si një objektiv kryesor të BE-së. Në këtë kontekst, Amendamenti i Gjellbër i propozuar për Kushtetutën e Kosovës është plotësisht në përputhje me procesin e integritimit në BE. Prosesi i zgjerimit ka treguar se kërkojnë ndryshime kushtetuese aty ku është e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të obligimeve të BE-së. Duke pasur parasysh që Kapitulli 27 i kushton rëndësi gjithnjë e më të madhe zbatimit, qasjes në drejtësi

dhe qeverisjes mjedisore të bazuar në të drejta, mungesa e një baze kushtetuese për të drejtat mjedisore mund ta kufizojë një pajtueshmëri të tillë. Në këtë kontekst, futja e një të drejte të tillë nuk duhet kuptuar si një kërkesë formale, por si një instrument funksional dhe gjithnjë e më i nevojshëm për të përmbushur standardet e efektivitetit të përfshira në *acquis*-në mjedisor të BE-së.³⁴

Në këtë kontekst, konstitucionalizimi i së drejtës për një mjedis të shëndetshëm do të funksiononte si një garanci themelore që u mundëson gjykatave dhe institucioneve t'i përdorin dhe operacionalizojnë standardet mjedisore të BE-së. Kjo pastaj do të forconte zbatueshmërinë e obligimeve nga Kapitulli 27, duke përfshirë mbrojtjen mjedisore brenda hierarkisë së normave, lehtësimin e shqyrtimit gjyqësor dhe duke siguruar që individët dhe komunitet e prekura - veçanërisht grupet e cënueshme - të mund të kërkojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre. Për pasojë dhe përderisa nuk është i përcaktuar zyrtarisht, një ndryshim i tillë pasqyron gjithnjë e më shumë një parakusht kushtetues *de facto* për një përputhje të besueshme me *acquis*-në mjedisore të BE-së dhe për të demonstruar sundimin e ligjit dhe pajtueshmërinë me të drejtat themelore që kërkohen për procesin e antarësimit.

Përfundim dhe rekomandime

Kushtetuta e Kosovës e parashikon mbrojtjen e mjedisit si një vlerë kushtetuese, por ende nuk e njeh të drejtën për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, si një e drejtë themelore e zbatueshme. Kjo është me të vërtetë një zbrazëti serioze kushtetuese, sepse të drejtat që lidhen me mjedisin, si bie fjala, qasja në informacionin mjedisor ose pjesëmarrja publike, parashikohen vetëm në legjislacionin kryesor sektorial dhe udhëzimet administrative përkatëse, por jo edhe në Kushtetutë.

Modeli aktual i rregullimit kushtetues nuk është i mjaftueshëm. Degradimi mjedisor në Kosovë është i dukshëm dhe tashmë po shkakton pasoja serioze për shëndetin publik, barazinë, drejtësinë sociale dhe zhvillimin. Ndotja e ajrit, ekspozimi ndaj toksinave, menaxhimi i dobët i mbeturinave dhe zbatimi joefektiv institucional prekin çdo person, por ato prekin në mënyrë më disproporcionale gratë, fëmijët, komunitetet me të ardhura të ulëta dhe grupet e marginalizuara. Në këtë kontekst, mungesa e një të drejte të qartë kushtetuese për një mjedis të shëndetshëm në Kushtetutën e Kosovës nuk është thjesht një aspekt i doktrinës, por ka pasoja të drejtpërdrejta dhe konkrete për qasjen në drejtësi dhe për individët që të kenë qasje në gjykata kur shkaktohet degradimi mjedisor.

Nga ana tjetër, e drejta kushtetuese krahasuese tregon se konstitucionalizimi i së drejtës për një mjedis të shëndetshëm jo vetëm që e ngritë mbrojtjen e mjedisit në nivelin më të lartë normativ, por gjithashtu u lejon individëve që të kundërshtojnë veprimet dhe lëshimet e dëmshme të autoriteteve publike dhe, kur është e përshtatshme, të aktorëve privatë. Kushtetuta e Kosovës tashmë e ka vendosur një pjesë të këtij themeli përmes neneve 7 dhe 52, por këto dispozita mbeten kryesisht programatike dhe pjesëmarrëse. Një amendament kushtetues i gjelbër do ta përfundonte këtë proces duke e shndërruar mbrojtjen e mjedisit nga një vlerë kushtetuese në një të drejtë kushtetuese.

Për më tepër, reforma kushtetuese e propozuar do të kishte edhe një vlerë strategjike, d.m.th., që do ta përfronte Kosovën më shumë me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë Rezolutën 76/300 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, dhe me trendin më të gjerë evropian drejt konstitucionalizimit mjedisor. Pastaj, do të përforconte dimensionin e sundimit të ligjit në qeverisjen mjedisore, do të mbështeste zbatimin më efektiv të obligimeve që dalin nga Kapitulli 27 për procesin e anëtarësimit në BE dhe do të sinjalizonte se Kosova është e përgatitur ta trajtojë degradimin mjedisor si një prioritet kushtetues dhe zhvillimor. Në këtë drejtim, njohja me kushtetutë e së drejtës për një mjedis të shëndetshëm duhet të kuptohet jo si reformë simbolike kushtetuese, por si një hap i domosdoshëm ligjor dhe institucional drejt mbrojtjes së të drejtave të brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.

Bibliografia

- 1 Marko, Joseph. "The new Kosovo constitution in a regional comparative perspective." *Rev. Cent. & E. Eur. L.* 33 (2008): 437; Doli, Dren, and Fisnik Korenica. "Calling Kosovo's Constitution: A Legal Review." *Denning LJ* 22 (2010): 51; Morina, Visar, Fisnik Korenica, and Dren Doli. "The relationship between international law and national law in the case of Kosovo: A constitutional perspective." *International journal of constitutional law* 9.1 (2011): 274-296; Morina, Visar. "Prospective Constitutional Changes in Kosovo Emanating from the EU Pre-Accession Process." *Croatian Yearbook of European Law & Policy* 12.1 (2016): 299-317.
- 2 See more on this Boyd, David R. "The constitutional right to a healthy environment." *Environment: Science and Policy for Sustainable Development* 54.4 (2012): 3-15; Hashim, Normawati Binti. "Constitutional recognition of right to healthy environment: the way forward." *Procedia-Social and Behavioral Sciences* 105 (2013): 204-210. Martens, Marc. "Constitutional right to a healthy environment in Belgium." *Review of European Community & International Environmental Law* 16.3 (2007): 287-297.
- 3 French Constitution of 4 October 1958, Preamble, referring to the rights and duties defined in the Charter for the Environment of 2004 available at https://www.conseil-constitutionnel.fr/sites/default/files/as/root/bank_mm/anglais/constitution_anglais_oct2009.pdf
- 4 French Constitution of 4 October 1958, Preamble, referring to the rights and duties defined in the Charter for the Environment of 2004 available at https://www.conseil-constitutionnel.fr/sites/default/files/as/root/bank_mm/anglais/constitution_anglais_oct2009.pdf
- 5 Donald K Anton and Dinah L Shelton, *Environmental Protection and Human Rights* (Cambridge University Press 2011), 523
- 6 Constitution of the Commonwealth of Pennsylvania, art I, § 27.
- 7 Constitution of the State of Hawai'i, art XI, § 9.
- 8 <https://www.unep.org/explore-topics/environmental-rights-and-governance/what-we-do/advancing-environmental-rights/what-0>
- 9 Donald K Anton and Dinah L Shelton, *Environmental Protection and Human Rights* (Cambridge University Press 2011) 523-530 discussing the case *Montana Environmental Information Center et al. v. Department of Environmental Quality*, 296 Mont. 207, 988 P.2d 1236 (1999).
- 10 Donald K Anton and Dinah L Shelton, *Environmental Protection and Human Rights* (Cambridge University Press 2011), 523.
- 11 Donald K Anton and Dinah L Shelton, *Environmental Protection and Human Rights* (Cambridge University Press 2011).
- 12 Constitution of Spain, 1978, Art. 45; Charter for the Environment, integrated into the Constitution of France, 2004, Art 1; Constitution of Belgium, 1994 (revised), Article 23.
- 13 Norway Constitution, Article 112 "Every person has the right to an environment that is conducive to health and to a natural environment whose productivity and diversity are maintained. Natural resources shall be managed on the basis of comprehensive long-term considerations which will safeguard this right for future generations as well."
- 14 This Focus Group Meeting was organized by FES on 15th of April 2026 and gather representatives of the Ministry of Environment, CSOs engaged in environment and students from the Faculty of Law of the University of Prishtina.
- 15 European Commission, *Kosovo Report 2025* (Directorate-General for Enlargement and Eastern Neighborhood, 4 November 2025) https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2025_en accessed 21 March 2026
- 16 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, *Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit 2023* (Prishtinë, shtator 2024) <https://www.ammkrks.net/assets/cms/uploads/files/Raport%20vjetor%20p%C3%ABr%20gjendjen%20e%20mjedisit%20SHQIP%20ueb.pdf> accessed 21 March 2026.
- 17 On prevention, precaution, polluter pays, access to information, participation and access to justice, see Law No 03/L-025 on Environmental Protection, art 6 and art 34; Law No 04/L-147 on Waters of Kosovo, art 3, art 6(1.3), (1.6), (1.8), (1.10), and art 84; Law No 03/L-233 on Nature Protection, art 2(1.5) and art 5(1.1), (1.5), (1.7)
- 18 The EC Report for Kosovo is available at https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2025_en
- 19 United Nations Environment Programme, *Global Climate Litigation Report: 2025 Status Review* (3 October 2025) <https://www.unep.org/resources/report/global-climate-litigation-report-2025-status-review> accessed 10 April 2026
- 20 Law no. 05/L – 044 on the environmentally endangered zone of Obiliq and its surroundings.
- 21 Driton Shabani and others, 'Blood Lead Level of Children and its Trend in Mitrovica, Kosova' (2019) 9 *Journal of Child Science* e84 <https://doi.org/10.1055/s-0039-1693515>.
- 22 Organization for Security and Co-operation in Europe Mission in Kosovo, *Background Report: Lead Contamination in Mitrovicë/ Mitrovica Affecting the Roma Community* (February 2009) <https://omik.osce.org/sites/default/files/f/documents/f/8/36234.pdf> accessed 10 April 2026.
- 23 UNICEF Kosovo Programme, *Policy Brief: A Climate Landscape Analysis for Children* (2024) https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/6551/file/Policy%20Brief_CLAC-Long.pdf pdf accessed 10 April 2026.
- 24 Zana Shabani Isenaj and others, 'Air Pollution in Kosovo: Short Term Effects on Hospital Visits of Children Due to Respiratory Health Diagnoses' (2022) 19(16) *International Journal of Environmental Research and Public Health* 10141 <https://doi.org/10.3390/ijerph191610141>.
- 25 Government of Kosovo, *Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike 2025–2034 dhe Plani i Veprimit 2025–2027* <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/16-08-49-25112025/KCCAS-Albanian.pdf> accessed 31 March 2026.
- 26 *Jugheli and Others v Georgia* App no 38342/05 (ECtHR, 13 July 2017).
- 27 *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz and Others v Switzerland* App no 53600/20 (ECtHR Grand Chamber, 9 April 2024).
- 28 Kosovo Environmental Protection Agency, 'World Bank presents Kosovo environmental analysis' (14 June 2012) <https://www.ammkrks.net/en/lajmi-single/129> accessed 10 April 2026.
- 29 World Bank, *Kosovo Country Climate and Development Report* <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/publication/kosovo-country-climate-and-development-report> accessed 31 March 2026.
- 30 World Bank, *Air Pollution Management in Kosovo* (World Bank 2019) <https://documents1.worldbank.org/curated/en/214511576520047805/pdf/Air-Pollution-Management-in-Kosovo.pdf> accessed 31 March 2026.
- 31 World Bank Group, *Country Climate and Development Report: Western Balkans 6 – Kosovo Country Compendium* (October 2024) <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099100324121037634/pdf/P17920519a54a30bb1abe41c87eaa27d582.pdf> accessed 31 March 2026.
- 32 Swedish Environmental Protection Agency, Chapter 27 – EU accession (Environment and Climate Change) <https://www.naturvardsverket.se/en/international/work-eu/eu-accession/chapter-27/> accessed 30 March 2026
- 33 Swedish Environmental Protection Agency, Chapter 27 – EU accession (Environment and Climate Change) <https://www.naturvardsverket.se/en/international/work-eu/eu-accession/chapter-27/> accessed 30 March 2026.
- 34 Albi, Anneli. *EU enlargement and the constitutions of Central and Eastern Europe*. Cambridge University Press, 2005; Capeta, Tamara. "Croatian Constitution in EU Integration." (2020).

